

“Dhe kapnu që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur’anin) e All-llahut dhe mos u përcani” (Ali-Imran 163)

BESIMTARI

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamiëse Islame Shkoder
Viti I i botimit, Tetor 2007 Nr 6. Çmimi 20 lekë. www.gazetabesimtari.com

Krveredaktor Selim Gokaj



Gëzuar dhe për shumë vjet

F itër Bajramin

MUSLIMANET NE BALLKAN
JANE TE RREZIKUAR
DHE TE KERCENUAR

Abdi Baleta

Fq 2

BOTA PERFSHIHET NE POLEMIKA
PER BESIMIN E NENE TEREZES

Selim Gokaj

Fq 3

HALIL ISUFI, BAJRAKTARI
QË LA EMËR TË MADH

Riza Spahija

Fq 4

MEDREZEJA HAXH SHEH SHAMIA
HAP VITIN E RI SHKOLLOR

Selim Gokaj

Fq 5

MINBERI ESHTË TRIBUNE
E MENDIMIT ISLAM

Kasem Zylja

Fq 6

DEKLARATE PER
SHTYP E FMSH

Fq 7

TURQIA ESHTË GARANCI E PROBLEMIT TE SHQIPTARVE NE BALLKAN



Pas shkatërrimit të ish- Bashkimit Sovjetik, diplomacia turke u aktivizua edhe më shumë në arenën ndërkombëtarë edhe arriti të krijojë pozicione të reja në gadishullin e Ballkanit, të cilat janë në një linjë me interesat e amerikanëve. Dinamika i politikës së jashtme të Turqisë, shikohet në parandalimin e hegjemonisë së Serbisë dhe të Greqisë në Ballkan, duke rritur gjithashtu kapacitetin e saj diplomatik në të gjitha organizmat ndërkombëtare.

Sidomos radikalizimi i qarqeve të caktuara në Serbi dhe në Greqi ka bërë që vemendja e Turqisë në këtë rajon të jetë e kujdesshme, sepse ky radikalizim është në dëm të Shqipërisë dhe të Kosovës. Roli i Turqisë, si fuqi ballkanike, është i një rendësie të veçantë dhe ky rol duhet të merret parasysh në veçanti nga faktori kosovar dhe ai shqiptar, sepse në momentet me delikate të viteve të fundit që kaloi Shqipëria dhe Kosova, Turqia ishte shteti që vuri në dispozicion diplomacinë e saj dhe ishte e gatshme të

vinte në dispozicion të shqiptarve edhe forcën e saj ushtarake. Viti 1997 dhe lufta e fundit në Kosovë, janë tregues faktikë se Turqia është garanci e sigurtë për shqiptarët në Ballkan. Kur në vitin 1997 Greqia ishte e gatshme të dërgonte trupa ushtarake në Jug të Shqipërisë, gjoja për të mbrojtur minoritarët grekë në Shqipëri, qeveria turke u bëri të qartë grekëve se një sulm ushtarak mbi Shqipërinë do të konsiderohej nga qeveria turke si një sulm mbi Turqinë duke e detyruar qeverinë greke të deklarojë publikisht se nuk mund të dërgojë trupa në Shqipëri, sepse do të sulmohej nga aleati i saj historik, Turqia. Kur qeveria serbe e Millosheviçit po bënte një spastrim të ashpër etnik në Kosovë, qeveria turke lëvizi me shpejtësi diplomacinë e saj duke shpejtuar ndërhyrjen e forcave ndërkombëtare në Kosovë dhe pasi filluan sulmet e NATOS mbi Serbinë, avionët turq e lëshonin të gjithë ngarkësën e tyre në objektivat serbe duke mos qenë në një linjë me avionët francezë që

Vijon...

MUSLIMANET NE BALLKAN JANE TE RREZIKUAR DHE TE KERCENUAR



Trojet ballkanike, ku shumica e popullsisë është muslimane, në të cilat hyjnë Bosnja, Kosova, Shqipëria dhe Shqipëria Lindore, janë quajtur nga studjuesit perëndimorë "Evropa Myslimane" ku ka qenë në mbrojtje dhe jo në sulm. Ajo që është shqetësuese ka të bëjë me faktin se muslimanët kanë qenë vazhdimisht në tërheqje dhe nuk kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm për të rritur vlerat e islamit në këto por, ai ka qenë dhe mund të jetë aktiv vetëm nga ndikimi islam që mund të vijë nga bota islame. Shqetësimi për këtë hapësirë muslimane në Ballkan, e nxiti Vatikanin që të jetë aktiv gjatë luftës që u bë në Bosnje dhe më pas në vitet e luftës në Kosovë. Serbët spekuluan duke thenë se vatrën muslimane në Ballkan mund të bëhen qendra të fundamentalizmit islamik duke u përpjekur të fitojnë simpatinë e Perëndimit, për të përligjur genocidin e tyre kundër muslimanëve të cilin e ushtruan në Bosnje dhe në Kosovë. Ballkani është i njohur si një nga tri zonat ku muslimanët, të krishterët dhe hebrenjtë kanë jetuar në harmoni. Por, kjo hapësirë është e njohur edhe për betejat e ashpra duke u bërë shesh kryqzatash dhe objekt i rikonkuistës së krishterë. Sot, Ballkani është kthyer në një zone ku shtrohet frikshëm problemi në se muslimanët do të jetojnë në këtë hapësirë, apo do të zhduken, siç ka ndodhur në Spanjë, ku sot Islami është zhdukur, falë masakrave që u bënë në emër të rikonkuistës famëkeqe spanjolle. Në Ballkan ka një frikë reale për të ardhmen e

muslimanizmit gjë që e vë në dukje edhe studjuesi britanik Uittkrof i cili, në një studim të tij, vë në dukje se lufta me Islamin në Ballkan, në trupin e vetë Evropës, u bë më e dhunshme se në secilën nga betejat e mëparshme. Ballkani u bë skena ku luhej akti final i përleshjes së Evropës së krishterë me Islamin dhe për fat të keq pasojat e këtij antagonizmi kanë vazhduar edhe pas daljes nga skena politike e Perëndorisë Osmane dhe rizgjimi i ideve të largëta shërbeu si si zjarrvënje për mizoritë e shekullit të XX, ku më shumë bien në sy këto mizori në Bosnje dhe në Kosovë. Ata që përçojnë rrymën islamofobe në mendim dhe në propogandën shqiptare, kanë prirje që ta paraqesin luftën e serbve ndaj boshnjakëve si një luftë me motive fetare, duke mohuar synimet reale të Serbisë për një shtrirje në kuadrin e gjeopolitikës së saj. Ndërsa, përplasja me shqiptarët trajtohet nga islamofobët si rrjedhojë e gjeopolitikës serbe duke mohuar edhe përplasjen fetare me pikësynimin për të përjashtuar rolin e dobisë që u ka sjellë islami shqiptarëve në përplasjet me fqinjët e tij të krishterë fakt që e pohon edhe figura e njohur e politikës amerikane, z. Ollbraj, kur thotë se betejat, që shpërthyen pas shpërbërjes së ish- Jugosllavisë dhe në Kosovë, ishin mbjellë në historitë fetare të rajonit.

Muslimanët në Ballkan vazhdojnë të jenë në pozita mbrojtjeje, sepse vazhdojnë të jenë të kërcënuar dhe kanë mbetur si ishuj në një det të krishterë, duke qenë kështu pjesa më e shkëputur nga bota islame, duke mbetur kështu të zbuluar përballë strategjisë antimuslimane që sot është në kurbën e saj më të lartë Një strategji kundër muslimanëve në Ballkan ka ekzistuar dhe është përsëri sot në rend të ditës e cila duket qartë pas ndërhyrjes së NATOS në Kosovë, ku të drejtat e shqiptarëve janë larg paramerave të normave ndërkombëtare

Sot, feja muslimane e kosovarëve keqpërdoret duke thurur ide se ato do të hyjnë në Evropë, kur ta braktisin fenë islame Rrezik islamik nuk mund të krijojnë në Ballkan as boshnjakët, as shqiptarët. Por, është fakt se në hapësirat ballkanike, ku jetojnë popuj muslimanë, ka një rrezik real për Islamin i cili është një rrezik real për muslimanët boshnjakë dhe ata kosovarë. Shqetësimi i madh është fakti se muslimanët në Shqipërinë londineze janë më të keqtrajtuar, më të fyer dhe më të nëpërkëmbur se në Bosnje, Kosovë Maqedoni dhe janë më të dobët në qendresën e tyre për të mbrojtur përkatësinë fetare, sepse në këtë hapësirë muslimane, sot, ka shpërthyer një islamofobi e çmendur që sulm

nga vendet fqinje dhe nga Perëndimi të cilët kanë një strategji të rrezikshme antiislame. Në Shqipëri, islamofobët po çirren se Shqipëria ka lidhje me Al Kaedën dhe me Bin Ladenin duke na bindur se në Shqipëri ka sot forca dhe mjete të fuqishme që bëjnë për muslimanët shqiptarë një tmerr akuzash, siç bënte inkuizicioni në Spanjë, kur penalizonte viktimat e tij. Muslimanëve, në Shqipëri, po u thuhet se feja islame është fe e pushtuesit dhe se ata në thelb qenkan të krishterë Sot, po qarkullojnë teori dhe arsyetime të rrezikshme kundër muslimanëve shqiptarë, duke u kërkuar me kërcënim të konvertohen në të krishterë. Drejtuesit më të lartë shtetërorë shpallin se do të fshijnë 555 vjet të historisë së shqiptarëve dhe muslimanët shqiptarë janë muslimanë të kryqit. Sot organet shtetërore po realizojnë një kartë identiteti me figura shënjtoresh katolike. Në Shqipëri nuk po pushojnë zërat e islamofomëve për ta larguar atë nga Konferenca Islamike edhe pse figura të njohura të politikës evropiane e quajnë vlerë evropiane praninë e Shqipërisë në këtë organizëm ndërkombëtar. Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, që solli disfatë për komunizmin, Perëndimi e gjeti armikun e tij të ditës, të cilin në realitete sajoi vetë. Ai tashmë ishte Islami që Perëndimi po e pasqyron haptas si kundërshtarin e tij i ri, gjë që teorikisht e formuloi si përplasje të qytetërimeve. Pas 11 shtatorit, dolën tezat e islamofashizmit, me synimin për të krijuar një koalicion të ri botëror kundër Islamit. Forcat islamofobe botërore tashmë kanë plane për të goditur zemrën e Islamit, duke i detyruar muslimanët që të ndeshen me njëri tjetrin. "Nga xihadi në fitna", është leksioni, që islamologu francez, Kepel ka hedhur në publik, ku tregohet strategjia e re kundër Islamit e cila shikohet qartë në Afganistan, Irak Liban dhe pse jo edhe në Shqipëri. Islamofobia shqiptare nxiti kontradikta artificiale në mes muslimanëve për të dobësuar unitetin e tyre.

Tashmë është shumë e qartë se në të ardhmen muslimanët shqiptarët do të ndeshen me shumë pengesa, të cilat janë të përcaktuara nga faktorë ndërkombëtarë, ballkanikë dhe shqiptarë që kanë një strategji të përcaktuar mire kundër muslimanëve në Shqipëri dhe në të gjithë Ballkanin

ABDI BALETA

e lëshonin ngarkesën e tyre të përgjysmuar, ose në hapësira të vdekura, duke mos ndëshkuar agresorët serbë për krimet e tyre ndaj popullsisë së pambrojtur shqiptare.

Qëndrimi i diplomacisë turke pas rënies së komunizmit në Evropë është i fokusuar shumë në Ballkan, ku ajo ka interesa strategjike dhe ka gjithashtu detyrime ndaj shqiptarëve, me të cilët historia i ka lidhur shumë në etapa të ndryshme të saj. Tashmë duket qartë një diplomaci turke që ka një strategji e cila ka synimin e saj final neutralizimin e ribizantizimit të Ballkanit, që përbëhet nga fronti ortodoks: Rusi-Ukrainë Serbi dhe Greqi.

Ky front po riorganizohet për të luftuar Islamin në Ballkan, i cili mori ngjyrë konkrete me masakrat e papara në Bosnje që u pasuan me krimet që u bënë në Kosovë ku kemi një popullsi dominante muslimane. Pikërisht në këto hapësira muslimane, ushtria dhe paramilitarët serbë rrenuan pa mëshirë xhamia dhe medreze, të cilat nuk ua kishin zënë rrugën. Eshtë pikërisht Turqia ajo që po bën të pamundurën, që të spositojnë nga Ballkani synimet territoriale të "Frontit ortodoks" ndaj territoreve etnike shqiptare.

Por, ka qarqe në hapësirat shqiptare, të cilat për arsye politike dhe më shumë fetare po e shohin gjallërimin e diplomacisë turke në Ballkan, që po vepron

në mbrojtjen e çështjes shqiptare, si një ringjallje të fundamentalizmit islamik turk. Kjo tezë është sajuar nga propoganda e rrezikshme serbe dhe nga armiqët që nuk mungojnë në Perëndim që janë rreshtuar historikisht kundër shqiptarëve muslimanë të cilët po i shohim edhe sot duke iu kundërvënë Pavarësisë së Kosovës.

Por, politika shqiptare, në të gjitha hapësirat ku jetojnë shqiptarët, nuk duhet të bjerë vktimë e kësaj politike që e paraqet Turqinë rrezik potencial për të gjithë shqiptarët, sepse është pikërisht Turqia garanti më serioz dhe i vetmi për mbrojtjen e pavarësisë së Shqipërisë si edhe i vetmi garant për të zgjidhur çështjen shqiptare në Ballkan. Në se ka sot një qeveri dhe një shtet në botë që është i gatshëm të dërgojë ushtarët e vet për të luftuar dhe për të rënë në luftë për shqiptarët, ai është shteti turk dhe qeveria turke.

Ne urojmë që ajo ditë të jetë sa më e largët, por e vërteta është se sot prapavija të rrezikshme të politikës botërore po grumbullojnë mbi qiellin e Ballkanit retë e zeza të luftës, flakët e së cilës nuk dihet se ke do të përvëltonë më shumë, ato që mund ta ndezin luftën, apo ato që janë planifikuar të përvëllohen.

SELIM GOKAJ SHKODER ME, 2TETOR 2007

BOTA PERFSHIHET NE POLEMIKA PER BESIMIN E NENE TEREZES

Festimet që u bënë ditë më pare me rastin e 10 vjetorit të Nënë Terezës, të cilat kulmuan me nderimet që i bëri qeveria shqiptare duke shpallur 10 ditë aktivitete për nder të kësaj shenjtoreje katolike, të na kujtuan javën e Enverit të cilën e pat projektuar pasuesi i tij famëkeq, Ramiz Alia, nxorën në opinjonin publik botëror anën tjetër të medaljes së kësaj misionareje katolike e cila, krahas buzëqeshjes së saj të njohur, mbante edhe shenime në formën e letrave ku ajo bënte portretin e saj të vërtetë të cilin askush nuk e njihte deri sa u bën publike nga se vetë kasha që nuk zbatoi një kërkesë të saj para vdekjes ku, kjo zojë e nderuar, lutej që të shkatërroheshin të gjitha letrat dhe çdo gjë që ajo kishte shkruar. Jo vetëm ato që e simpatizonin atë dhe misionin e saj, por edhe ato që nuk ishin aq pranë veprës së saj, u shokuan kur pane se tani bëhej fjalë për një mashtruese e cila kishte si tipar themelor të saj hipokrizinë. Nga letërkëmbimi me ato që quhen "shefat" e saj, tashmë bëhet e qartë se ajo ishte një misionare që bënte bamirësi në interes të shefave të saj nga edhe ajo varej, tregues ky që e qartëson edhe misionin e saj të vërtetë duke treguar se bamirësia e saj ishte në fakt detyrë e ngarkuar nga një prapavijëfetare. Sapo ajo ngriti misionin e saj të bamirësise, tek Nënë Tereza filluan dyshimet në se egziston Zoti(Jezusi) dhe se a duhet të besojë apo jo. Duke kaluar nga një prif tek një tjetër ajo do të shpaloste figuren e saj të vërtetë që nuk kishte azgjë të përbashkët me atë pamjen e saj të përvuajtur dhe me atë buzëqeshjen e saj enigmatike. Në të gjitha rrëfimet e saj ajo do të bëhet edhe më transparente duke deklaruar se është pa besim, e braktisur dhe me shpirt të zbrazur. Në letrat e saj ajo shkon aq larg sa është e penduar për punën që ka bërë duke e shkelur atë me këmbë, sepse për Nënë Terezën nuk ka Zot dhe si pasojë nuk ka arsye të punojë. Ajo do të pohojë në letrat e saj se edhe Jezusi nuk është i vërtetë. dhe se për atë tashmë Jezusi nuk është më në lutjet e saj. Sidomos të bëjnë shumë përshtypje momentet e kalimit në ekstazë të Nënë Terezës kur ajo i lutet Jezusit që ai ta dojë se ajo është e tija dhe se ajo i lutet që Jezusi të bëjë me atë gjithshka që ai don, siç don ai dhe sa kohë që don ai.

Në letrat e saj ajo do të vazhdojë të deklarojë hapur se nuk beson dhe nuk ka guxim që të nxerr fjalët dhe mendimet që ajo ka në zemrën e vet. duke pohuar njëkohësisht se asaj i mungonte Zoti dhe po jetonte në errësirë.

Tashmë Nënë Tereza nuk do të hezitohet që të prekë edhe majën e pasigurisë së saj shpirtërore duke shkruar në letrat e saj se ajo ndoshta ka gabuar që i është dorëzuar verbërisht Thirrjes së Zemres së Shenjtë.

Janë 40 letra ku ajo ka hedhur mendimet dhe ndjenjat e veta dhe për fat të keq shumë nga ato nuk janë botuar megjithëse flitet se ato e kanë pare ose do ta shohin shpejt dritën e botimit.

At Martini do të deklarojë se Nënë Tereza ishte e paaftë që ta përceptonte Krishtin(Zotin) duke e zbritur shumë shkallë poshtë nga piadestali kua ka vënë misionin që ajo kryente në emër të shefave të saj. , sepse ajo vetë ishte e njohur jo si e pasur në një kohë që të hapësh misionin në të gjithë botën duhen para dhe para kanë vetëm "Shefat e mëdhej"Ka mundësi që pa dashjen e

saj ajo zbulon se është shumë hipokrite, sepse këtë do të pohojë në shkrimet e saj duke thenë se buzëqeshja është një maskë apo një vello që mbulon gjithshka. Ajo dyshon se është duke mashtruar me misionin e saj, kur pohon, në një letërkëmbim me një këshilltare të saj, të cilës i drejtohet duke i thenë se ti po të ishe aty do të thoje: "Çfare hipokrizie"

Këto letra, që la pas Nënë Tereza dhe dilemat që ajo kishte për misionin e saj dhe në atë se egzistonte apo jo Zoti, vështirë të pohosh se nuk e dinin "Shefat" e saj. Por, atyre, që financonin misionin e saj dhe që ishin prapavijë e saj, nuk i interesonte shumë se çfarë mendonte Nënë Tereza, apo në se besonte dhe sa besonte Nënë Tereza. Atyre u

interesonte shkalla e realizimit të misionit të saj në sasi dhe në cilësi, sepse ato investonin në këtë mision për të lartësuar religjonin të cilit po i shërbente kjo misionare simbolin e të cilit ajo me misionarët e saj e kishin të

varur në rrobat e tyre. Nën maskën e një misionit bemires, ato afronin me ndihmëm e Nënë Terezës të varfërit pranë fesë katolike, duke e zbuluar këtë mision bemires si mision që ka një prapavijë një që është më e rendësishme bamirësi e cila është misioni fetar katolik. Prandaj, ne kemi të drejtë që Nënë Terezën e quajmë misionare fetare katolike, sepse bazohemi tek misioni i saj i vërtetë të cilin e nderojmë, por njëkohësisht e emërtojmë me emrin e tij të vërtetë.

Nuk e kemi të qartë në se qeveria shqiptare e njeh të vërtetën për misionin e saktë të Nënë Terezës dhe se çfarë

asryetimi ka përdorë për të piketuar hapësira të panumurta për të vendosur bustin e Nënë Terezës që ka kulmuar me bustin në areropotin më të madh të Shqipërisë kuai pozon në formë të qartë të një kryqi, duke cënuar edhe identitetin fetar të shumicës së popullsisë që ka përkatësi fetare muslimane Por, lajthitja e qeverisë shqiptare në

përpjekje për t, i dhënë hapësira të pamërituara kësaj figure shumë të kontestuar, arriti kulmin kur ajo planifikoi që në kartën e identitetit të vendoset figura e NënëTerezës duke dhënë një arsytim jo bindës se ajo është një bamirëse e madhe me origjinë shqiptare. Me të drejtë reagoi Këshilli i Përgjithshëm i KMSH duke e bërë në media publik kundërshtimin e këtij organi drejtues të muslimanëve shqiptarë, sepse qeveria po rrëzon karakterin laik të shetit shqiptar. Flitet se qeveria ka plane për ta heqë këtë figure fetare nga karta e identitetit siç flitet për plane për të reagu bashkësi qytetare dhe shoqata muslimane ndaj këtij hapi të pastudjuar mire nga qeveria shqiptare e cila duket se këto veprime i bëjnë shumë nga halli sesa nga madhi. Dëshrojmë që hallet e qeverisë sonë të zvoglohen qe pastaj edhe shqetësimet e muslimanëve të ndëgjohen.

SELIM GOKAJ
SHKODER. , 3 TETOR 2007

Pyetje-Përgjigje rreth Islamit

**A nuk është e vërtetë se
Islami është përhapur me shpatë?**

Përgjigje:

Jo. Kjo nuk është e vërtetë. Megjithatë, në mendjet e shumë njerëzve ka një keqkuptim të dukshëm. Në Kur'an thuhet:

"Në fe nuk ka dhunë. është sqaruar e vërteta nga e kota" (Kur'an 2:256).

Ky varg i Kur'anit tregon se Zoti ka bërë që e vërteta dhe gënjeshtra të dallohen qartë nga njera-tjetra dhe për këtë arsye njerëzit janë të lirë të zgjedhin njërin ose tjetrën. Askush nuk mund të detyrojë njeri të besojë në fe sepse besimi është diçka shumë vetjake, personale. Ai që ndjek mësimet e Kur'anit nuk duhet të përpiket t'ua imponojë atë të tjerëve.

Edhe Profeti Muhamed a.s. kurrë nuk kërkonte të bënte ndokënd musliman me forcë. Ja se çfarë i kishte shpallur Ai atij:

"Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t'i besonin çka janë në tokë që të gjithë. A ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë? Nuk është e mundur për asnjë njeri të besojë (ndryshe), pos me ndihmën e Allahut" (Kur'an 10:99-100). Nga kjo urdhëresë e Zotit bëhet e qartë se kushdo që mendon se mund të detyrojë të tjerët të besojnë, e ka gabim. Po të dëshironte Zoti, Ai mund t'i bënte të gjithë njerëzit besimtarë, por Ai parapëlqeu që këtë t'ia lërë vullnetit të tyre të lirë. Kështu që, askush nuk mund të detyrohet të besojë me forcë. Besimi është dhuratë e Zotit ndaj njeriut. A ka udhëzim e mësim më të mirë se ky? Si mundet një besimtar e ndjekës i vërtetë i Kur'anit t'ia kthejë shpinën këtij udhëzimi e t'ua imponojë besimin të tjerëve?

Përkundrazi, ja se si udhëzon Kur'ani ndjekësit e tij që t'u bëjnë thirrje njerëzve për te besimi i vërtetë:

"Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët me atë mënyrë që është më e mira" (Kur'an 16:125).

Ku thotë Kur'ani që t'u bëhet thirrje njerëzve me shpatë të koka? Askund. Zoti e udhëzonte të Dërguarin e Tij a.s. me këto fjalë:

"Thuaj: Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras te Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje" (Kur'an 12:108).

Edhe këtu, vihet në dukje që thirrja për në Islam të bëhet me dije të sigurt, me prova të qarta. Duke i pasur parasysht të gjitha këto, për çdo musliman është e kuptueshme se ai duhet ta paraqesë Islamin me prova të qarta (d.m.th., me njohje të sigurt) dhe t'i përdorë ato me urtësi e me ton këshillues e me dashamirësi duke arsyetuar me njerëzit që t'i pranojnë provat në mbështetje të besimit. Ç'hyn shpata këtu?

Në Enciklopedinë Junior të Kanadasë lexojmë:

"Islami është feja që po përhapet më me shpejtësi në gjithë botën" (The Junior Encyclopedia of Canada, 1990, Vëll. 2, f.396).

Këtu të lind pyetja: Kush po detyron sot ndokënd të bëhet musliman? Bile, muslimanët as që janë të angazhuar në mënyrë pak a shumë aktive në fushën e predikimit. Njerëzit po e përqafojnë Islamin me vullnetin e tyre të lirë sepse atë ua pranon arsyeja dhe logjika.

Huston Smith në librin e tij Fetë e Botës dhe pikërisht në faqen 256, na tregon se Profeti Muhamed a.s. u siguronte lirinë e besimit çifutëve dhe të krishterëve nën qeverisjen e muslimanëve. Profeti kishte hartuar një dokument të tillë ku thuhej se çifutët dhe të krishterët duhet të "mbrohen nga çdo fyerje dhe ngacmim; ata kanë të drejtë njësoj si populli ynë që të gëzojnë ndihmën tonë dhe trajtim të barabartë", dhe më tej, ata "do ta praktikojnë fenë e tyre lirisht sikurse muslimanët". Smith vë në dukje se muslimanët e konsiderojnë këtë dokument si "Karta e parë e lirisë së ndërgjegjes në historinë e njerëzimit dhe një model që duhet të ndiqet nga çdo shtet musliman në të ardhmen" (f.256).

Atëherë, a është përhapur Islami me anë të shpatës? Ja si përgjigjet në mënyrë të përmbledhur Ira Zepp, i cili nuk është musliman, në librin e tij të cituar më lart:

"Është fatkeqësi që Islami ka qenë portretizuar si 'fe e shpatës' ose se Islami 'është përhapur me anën e shpatës'. E vërteta historike pohon se Islami zakonisht është përhapur me bindje dhe jo me anë të fuqisë ushtarake. Sido që të jetë, Islami nuk mund t'i detyrohet askujt; në qoftë se, ta zëmë, dikush detyrohet me forcë ta shqiptojë shehadetin (d.m.th. deklaratën e pranimit të Islamit), kjo s'ka të bëjë fare me Islamin e vërtetë" (*Mësime fillestare për muslimanin*, nga Ira Zepp, Jr., 1992, Wakefield Editions, US, f.134).

HALIL ISUFI, BAJRAKTARI QË LA EMËR TË MADH

Të merresh me grumbullimin e materialit, studimin dhe hulumtimet e personaliteteve më në zë të Postribës në rrjedhen e historisë, është jo vetëm një detyrë e përkushtim njerëzor, por edhe një punë e vështirë e me përgjegjësi. Informacioni që u vihet në dispozicion lexuesve dhe studiuesve duhet të pasqyrojë sa më sakt realitetin, rrethanat dhe kushtet historike, si dhe të kompletojë personalitetin duke paraqitur temperamentin dhe karakterin e tij, figuren popullore, historike e politiko-shoqërore të kohës në të cilën jetoi.

Nga historianë mësojmë se Pricipata e Balshajve shtrihej në një territor mjaft të gjërë, nga Shkodra deri në zonën e Pricipatës së Dukagjinasve. Në këtë territor ka pasur edhe familje e fise të krijuara nga martesat e oficerëve turqë më gra vendase. Në këto kushte u krijue edhe fisi i bajraktarit të Drishtit, me mbiemër "Muhaj". Sipas trashëgimisë gojore fisi Muhaj arrin 12-13 breza muslimanë, që po të llogaritet me 35 vjet jeta mesatare e një brezi, rezulton që të jetë një periudhë prej 400 vjetësh në vazhdimësi muslimanë, pra që nga viti 1600 i Erës Sonë.

Halil Isufi i fisit Muhaj, erdhi në këtë jetë rreth viteve 1845, në lagjen Kala të ish qytetit Drivast (Drishti i sotëm). Njeriu i parë i këtij fisi quhej Muho, i cili ka pasur edhe dy vëllezër të tjerë. Të tre vëllezërit mendohet të kenë ardhur nga Turqia me detyra ushtarake dhe fetare. Ata fillimisht u vendosen në fshatin Kullaj-Boks të Postribës. Vëllai i vogël, i njohur me emrin "Hoxha i Dheut të Drishtit" u largue nga Postriba dhe u vendos në Shkodër, në vendin e quejtur "çinari i Hoxhës së Dheut", afër stadiumit "Loro Boriçi" sot. Ky emer i zonës u vendos për nder të tij. Ai studioi për fe dhe gjithë jetën ia kushtoi religjionit në Shkodër. Muhja, vëllai i dytë u largue nga Kullaj-Boksi dhe u vendos në Kala të Drishtit, ku krijoi degen e tij, që më vonë moren përsipër detyrën e bajraktarit. Vëllai i madh qëndroi në Kullaj-Boks. Përpara fisit të Halil Isufit, detyrën e bajraktarit e kryente një fis nga Vilza i quejtur "Hetaj". Për kalimin e bajrakut nga Vilza në Drisht u bë shkak një ngjarje. Postriba bie në përpjekje me forcat malazeze, në luftë për mbrojtjen e trojeve, thuhet në vendin e quejtur Maja e Helmit. Këtu vritet bajraktari i Vilzës që mbante flamurin dhe duke mos pasur luftëtar tjetër të fisit të tij për ta zevendësuar, e merr flamurin një luftëtar nga fisi Muhaj i Kalasë së Drishtit, dhe nepërmas plumbash arrin ta ngrejë flamurin në Maje të Helmit. Megjithë fisnikërinë e fisit Muhaj për ta lënë bajrakun përsëri në Vilzë, këta, po me fisnikëri nuk pranuan ta mbanin më bajrakun, duke e quejtur trimëri ngritjen e flamurit në Majen e Helmit dhe në këtë mënyrë u bë kalimi i bajrakut nga Vilza në Drisht. I pari në fisin Muhaj e mori bajrakun i quejturi Hasë Bajraktari dhe pas vdekjes së tij e merr detyrën e bajraktarit Halil Isufi në një moshë të re. Ai ishte rreth 20 vjeç kur e merr këtë detyrë dhe e kryen në mënyrë të shkëlqyer deri ditën që u vra në moshën 76 vjeçare, rreth vitit 1921.

Halil Isufi ishte një nacionalist i devotshëm. Ai gjithë jetën e tij ia kushtoi mbrojtjes së trojeve. Së bashku me nacionalistët të tjerë të shquar në kohë të ndryshme si Tahir Haxhija, Adem Haxhija, Ymer Beqiri e Haxhi Idriz Boksi nga Postriba, Dasho Shkreli e Oso Kuka nga Shkodra, Dedë Gjoluli nga Hoti, moren pjesë në çdo betejë që u zhvillue në mbrojtje të sovranitetit dhe të integritetit tokësor. Halil Isufi merr pjesë në Rrethimin e Shkodrës me 1912, në luftën për mbrojtjen e saj. Osman Kupi nga Drisht na vë në dispozicion një akt guximi të jashtëzakonshëm të Halil Isufit në Rrethimin e Shkodrës. Ai tregon: Mali i Zi gjuen me topa primitiv nga Kratuli i Boksit në drejtim të Shkodrës. Predha bie brenda telave të rrethimit. Në atë moment Halil Isufi e kapë predhën me dy duartë, e vë atë në sup dhe siç ishte me fitil të ndezur e hedh atë jashtë telave të rrethimit dhe u jep urdhër luftëtarëve të ulen në



pozicion barkas deri sa të pëlcase predha. Kur plasi ajo i mbuloi luftëtarët me dhe por nuk u vra asnjëri."

Halil Isufi merr pjesë në Kryengritjen e Postribës në vitin 1916 kundra regjimit austro-hungarez. Në janar të vitit 1916 ushtritë austro-hungareze hyjnë në Shkodër. Ata porsa hynë vendosen regjimin ushtarak të pushtimit. Në popull ziente revolta e fuqishme kundër pushtuesit. Forcat popullore të organizuara dhe të udhëhequra nga Halil Isufi, bajraktari i Drishtit, Adem Haxhija, vojvodë dhe komandant popullor, bajraktari i Boksit dhe ai i Sumës, po përgatiteshin për të filluar një kryengritje të armatosur kundra pushtuesve austro-hungarezë. Komanda austro-hungareze e parashikonte rrezikshmërinë që paraqiste kryengritja, ndaj dhe u përgatit për të pënguar kryengritjen. Ajo dërgoi posaçërisht një fuqi të madhe ushtarake për të shtypur Kryengritjen e Postribës. Në Drisht ajo dërgoi një detashment ushtarak të pajisur me dy topa e gjashtë mitroloza, pasi Drisht ishte qendra e Postribës. Ajo përpigjet të shpërndajë kryengritësit që ishin organizuar dhe po prisnin urdhërin e fillimit të kryengritjes. Me gjithë që ky detashment zbrazti disa topa e mitroloza nuk ia arriti qëllimit. Kryengritësit, nën komanden e Halil Isufit e Adem Haxhisë me bajraktarin e Boksit nisen egërsisht kryengritjen. Detashmenti në përpjekje për të shpëtuar u nisen me ngut drejtë Shkodrës, por megjithatë afër Urës së Mesit la të vranë tre ushtarë dhe u zunë robër dy boshnjakë.

Halil Isufi së bashku me Adem Haxhinë merr pjesë edhe në Luftën e Koplikut në vitin 1920, ku forcat vullnetare të luftëtarëve të Postribës së bashku me luftëtarët shkodranë dhe ata të Malësisë së Madhe qëndrojnë heroikisht dhe i zbrapsin forcat pushtuese të armiqëve serbo-malazesë duke i nxjerrur jashtë trojeve shqiptare.

Halil Isufi ishte një njeri që i përkiste një temperamentit sanguin. Ai ishte i gjallë, i lëvizshëm, gjaknxehtë me mimikë të pasur. Ai ishte njeri shumë i afrueshëm dhe i dashur me njerëzit. Ai ishte njeri me ndjenja të forta por jo të thella e të qëndrueshme. Halil Isufi kishte humor të mirë, por këtë e kishte shumë të lëvizshëm. Ai lehtë, për diçka fare të thjeshtë kalonte në humor të keq. Ai ishte njeri me iniciativë, i guximshëm, i aftë për të gjetur zgjidhje në momente të vështira, siç qe rasti i largimit të predhës nga zona që rrezikonte jetën e luftëtarëve në Rrethimin e Shkodrës.

Halil Isufi ishte njeri me karakter të fortë. Për nga përmbajtja ai ishte me botëkuptim idealist dhe besimtar. Ai ishte njeri me vullnet të fortë për të përballuar vështirësitë e jetës, për të siguruar

mbijetesën njerëzore.

Halil Isufi ishte njeri i guximshëm, trim, besnik, bujar, i vendosur, nacionalist i devotshëm. Ai ishte i durueshëm dhe deri në njëfarë mase e zotëronte veten duke u përpjekur për të ruejtur gjakftohtësinë në raste konfliktesh, por ai nuk arrinte ta kontrollonte veten deri në fund. Ai kishte karakter burri, peshonte rëndë në fjalën dhe vepren e tij, ishte zemerbardhë, ishte i zgjuar.

Halil Isufi ka pasur fizionomi burrërore. Ai ishte autoritar. Mustaqet e gjata të kthyer pak sipër dhe me ngjyrë të kuqërremët deri në të verdhë duket sikur i jepnin fisnikëri e burrëri. Sytë e kuq i jepnin ashpërsinë dhe trimërinë. Fytyra e bardhë në të kuqe personifikonte bardhësinë e shpirtit dhe peshen e mençurisë. Ai mbante mbi krye qeleshe të bardhë të formës dibrane, vishte anteri me spik, xhamadan ari, çakçirë më spik, gybere shajaku. I veshur kështu ai të krijonte përshtypjen sikur ke përpara një plak dymijë vjeçar që shekujt nuk i hoqën gjë por i shtuan dhunti. Ai dukej sikur vinte nga thellësitë e historisë dhe udhëtonte drejtë pafundësisë.

Halil Isufi ishte njeri i vendosur në marrjen e vendimeve dhe në zbatimin e tyre. Ai nuk e kthente kurrë mbrapa një vendim të marrur edhe sikur të ishte në dëm të tij. Kjo përbënte, ndoshta, një ves të tij, të cilin nuk mund ta quajmë këmbëngulje për ta çuar deri në fund vendimin e marrur, por një kokëfortësi.

Halil Isufi ishte njeri i dashur dhe i sjellshëm në familje e shoqëri. Nuk i dhimbej asgjë nga pasuria e tij për pjesëtarët e familjes sepse, në fund të fundit, thoshte ai, pasuria është vënë me djersen e tyre, ndaj dhe duhet ta gëzojnë. Në familje jetonte me vëllezërit e tij, Tafë e Dan Isufi, të cilët i donte dhe i respektonte shumë.

Ai ishte burrë serioz, megjithatë ai e donte shumë këngën dhe muzikën. Ai pëlqente shumë këngët patriotike që këndoheshin me lautë e çifteli, e sidomos këngët me heronjë legjendarë si ato të Mujos e Halilit, të Gjergj Elez Alisë, etj.

Halil Isufi ka pasur pasuri dy kuaj shale, dy pendë qe, lopë, qindra krerë dhi, dele, etj. Ai kryent tregun e shtëpisë, merrej kryesisht me kuaj dhe i donte shumë ata. Ai, jo vetëm që merrej me drejtimin dhe organizimin e jetës familjare, por edhe me drejtimin e bajrakut, me pleqërim gjaqesh e konflikte të ndryshme shoqërore. Ai merrej me drejtimin e luftëtarëve në bashkëpunim me bajraktarët e bajraqeve të tjera të Postribës dhe të zonave fqinjë si Dukagjin, Shkodër, Hot etj. Ai bashkëpunonte edhe me vojvodët e komandantët popullorë të Postribës e zonave të tjera.

Halil Isufi nuk ka qenë njeri hakmarrës. Megjithatë, për çeshtje nderi, pristigji, integriteti tokësor, etj., ai nuk falte njeri, ishte i rreptë. Gjithashtu ai nuk falte edhe kur vartësit e tij nuk i zbatonin urdhërat që ai u jepte.

Halil Isufi i donte shumë njerëzit dhe nuk kishte komplekse fetare në drejtim të respektit e dashurisë. Ai donte shumë Beqir Velen e fisit Dushaj, Ymer Brahimin e fisit Halilaj në Dragoç dhe djalin e tij, Sadik Ymeri. Ai donte shumë familjen e Tyrbetarëve. Ai donte shumë Kolë Kirin, Kolë Xhuxhen dhe Sylço Begun me vëllezër që ishin prej fiseve të mira të qytetit.

Siç thonte, ai dinte edhe të urrente. Ai urrente shumë njerëzit e pabesë, frikacakët, hajdutët, gënjeshtarët, imoralët, etj. Ai urrente shumë pushtuesit serbë e malazesë, të cilët kishin vranë e plaçkitur disa herë gratë, fëmijë dhe pleqët e Postribës. Ata i kishin një borxh të madh Halil Isufit dhe Postribës, gjithë popullit shqiptar.

Halil Isufi ishte njeri shumë besimtar. Përpigjet të kryente të gjitha ritet fetare dhe faljet sipas normave Islame.

Halil Isufi ka pasur lidhje respekti e dashurie të

MEDREZEJA HAXH SHEH SHAMIA HAP VITIN E RI SHKOLLOR



Të marrësh pjesë në një ceremoni të hapjes se vitit të ri shkollor në një medreze është diçka e vaçantë, sepse e njeriu e sheh vehten në një ambjent disi të vaçantë me shkollat tjera, kur kemi parasysh se nxënësit e kësaj shkolle marrin edukate fetare islame aq e nevojshme sot, kur morali i shoqërisë në hapësirat shqiptare dhe më gjerë është vënë në një situatë kritike. Medrezetë janë ato mjedise ku nxënësit e saj, me moralin islam që marrin në ambjentet e medrezesë janë një barrierë e pakalueshme për këtë moral të dyshimtë me të cilin po ballafaqohet sot shoqëria shqiptare dhe më gjerë.

Ceremonia e hapjes së vitit të ri shkollor filloi me leximin e Kuranit Famëlartë nga një nxënësi kësaj medrezeje, lexim që u kujtoi të pranishmëve se ky libër hyjnor përcjell tek muslimanët mesazhin hyjnor që është çelsi i një jete të sukseshme për çdo musliman. . Pastaj e mori fjalën drejtori i medrezesë, Kujtim Dervishi, i cili përshëndeti

të pranishmit për pjesëmarrjen dhe foli për sukseset e medrezese në vitin e kaluar shkollor. Drejtori, Dervishi, vuri në dukje se viti i kaluar ishte i suksesshëm për këtë medreze, sepse nxënësit e saj arritën rezultate të larta në përvetësimin e dijeve shkencore dhe fetare duke i çuar këto dije edhe në konkurse lokale dhe kombëtare, ku konkuruan në lendë fetare dhe shkencore. Drejtori i medrezesë tha para të pranishmëve se rezultatet në këto konkurse ishin tepër të larta, sepse nxënësit e medrezesë zunë vende nderi, ku spikati nxënësi i kësaj medrezeje Ardit Muça i cili ishte pjesë e ekipit të Shqipërisë që mori pjesë në olimpiadën botërore për shkollat e mesme që u mbajt në Vietnam këtë vit. Të pranishmit, përmes fjalës së drejtorit, Dervishi, mësuan se në këtë vit shkollor medrezeja rregjistroi nxënës më shumë se në vitin e kaluar, duke treguar kështu se medrezeja Haxhi Sheh shamia ka dale plotësisht nga stanacioni i viteve më pare duke siguruar një

kontigjent nxënësisht që është vazhdimisht në rritje, tregues përcaktues që tregon interesimin në rritje të qytetarve shkodoranë për t, i pare nxënësit e tyre në bankat e kësaj medrezeje. Tashmë është bërë normë që medrezeja të ketë dy klasë të pesta dhe klasat e mesme të kenë një rritje të kënaqshme. Duhet pranuar se këto rezultate të larta në mësim dhe kjo rritje e pandërprerë e kontigjentit të nxënësve në medrezenë Haxhi Sheh Shamia, kanë edhe kontributin i padiskutueshëm të drejtorit të saj të suksesshëm, Kujtim Dervishi, i cili është ai që mund ta quajmë me të drejtë "I kudondodhuri në hapësirat e medrezesë" për të siguruar suksesin e gjithanshëm të saj. Ishte e domozdoshme që drejtori, Dervishi, të falenderonte shoqatën Islamik Reliev, me drejtuesin e saj Muhamed Elvai që financuan medrezenë Haxhi Sheh Shamia 15 vjet, duke u lënë hapësira atyre që drejtuan këtë institucion fetar- shkencor me dëshirën e mire që ajo të kryejë sa më mire detyrën e saj. Rezultatet e arritura treguan se strategjia e Islamik Relievit për medrezenë ishte e drejtë.

Pastaj, përshëndeti drejtuesi i shoqatë turke Istanbul e cila ka marrë përsipër financimin e medrezese që nga ky vit shkollor. Shuajp Bashan, pasi përshëndeti të pranishmit, tha se shoqata Istanbul do të jetë garant për arritjen e sukseseve nga ana e medrezesë.

Pasi përshëndeti myftiu i Shkodrës, Ndrizim Sulejmani dhe përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Arsimit, të pranishmit dhe të ftuarit u larguan për t, ia lënë rrallën fillimit të mësimin në medreze, ku nxënësit, sot, filluan ditën e pare të vitit shkollor 2007 2008.

SELIM GOKAJ
SHKODER, ME 20 SHTATOR 2007

NE KULLAJ ME IMAM KUJTIM ISUFAJ

Pasi kishim bërë një bisedë paraprake me imamin e xhamisë së fshatit Kullaj për të përcjellë një orë mesimi me nxënësit e këtij fshati në abjentet e xhamisë, ramë dakort që të nisemi të nesërmen në Kullaj me makinën e imam Kujtimit. Duke udhëtuar ,imami iu përgjegj shumë pyetjeve që unë i bëra duke më treguar se fshati Kullaj është i banuar në mënyrë absolute me muslimanë dhe se në këtë fshat ka 400 shtëpi dhe se muslimanët kësaj hapësire janë besimtarë të devotshëm. Pasi iu afroam fshatit Kullaj, na doli para sysh xhamia e fshatit që ishte e ndërtuar në një maje të thepisur që dominonte gjithë hapësirën që shtrihej në të katër anët e horizontit.

Pasi u ulëm nga makina, së bashku me imam Kujtimin iu drejtua xhamisë Që kishte një barrierë pak të vogël për të arritur në abjentet e saj ,e cila ishte numuri jo fort i vogël i shkallave që të çonte pranë saj.

Pak nga pak filluan të vijnë pranë xhamisë nxënësit që janë pjesë e grupit i cili vazhdon mësimet fetare me imamin e xhamisë. Më bëri përshtypje sa shpejt u rrit numuri i nxënësve duke e bërë të mundur fillimin e mësimin që ishte një orë e zakonshme për vetë këto nxënës.

Mësimi fillon me pyetjet që imam Kujtimi u drejton nxënësve të cilët janë të gatshëm të japin përgjigje për pyetjet që u drejtohen atyre. Vëmë re se pyetjet që u drejtohen nxënësve kishin të bënin me suret e Kur-anit Famëlartë dhe me tematika të tjera fetare që kishin lidhje me moralin islam. Ishte i rëndësishëm fakti se imam Kujtimi ndërhynte për të krijuar edhe më shumë hapësirë për përgjigjen që jepnin nxënësit e kursit fetar që të marrë maksimumin e asaj që nxënësit kishin përgaditur. Njeriu ndjente kënaqësi kur shikoje të gjithë nxënësit që ngrinin duart për të thënë sejcili i pari atë që kishte përgaditur për këtë orë mësimi fetar.

Pasi nxënësit e kursit fetar japin përgjigje për pyetjen që u drejtohet , imam Kujtimi jep vlerësimin e përgjigjes duke e komentuar atë për ta bërë sa më të pranueshme nga nxënësit që përgjigjen. Eshtë ditë e shtunë e dates 15 shtator dhe ne vazhdojmë të përcjellim një përgaditje me të vërtetë të kënaqshme e cila pa tjetër që ka të bëjë edhe me një përgaditje dhe një kujdes të madh nga imam Kujtimi për të cilin nxënësit e shprehin respektin për atë duke prezantuar një përgaditje që do t'ia kishte zili edhe një nxënësi që shkon në shkollë çdo ditë. Eshtë një kënaqësi që rrallë e provon njeriu ,kur ndëgjon duke u kënduar Kur-ani nga këto vajza që tashmë fenë islame e kanë pjesë të rëndësishme të jetës së tyre. Ata janë të mbuluara me shamia si muslimane që zbatojnë porosinë e Allahut të madhërueshëm me pikësynim për ta mbajtur më vonë edhe jashtë ambjenteve të xhamisë. Eshtë e vështirë të bësh dallime ,sepse ato janë të gjitha muslimane që mësojnë për fenë islame dhe është respekti për fenë islame që i bën të jenë në ambjentet e kësaj xhamie për të mësuar për fenë islame. Pasi mbaroi mësimi, u larguam me përshtypje të veçanta që i provon njeriu vetëm kur është pranë fëmijve muslimanë të cilët i vë në lëvizje për të marrë dije islame vetëm shpirti i tyre, ku ka bërë folenë e vet dashuria për Allahun e Madhërueshëm dhe Profetin a.s Duke u kthyer me imam Kujtimin nga fshati Kullaj, unë i premtova se do të jetë kënaqësi për mua po të më ftonin për të qënë pranë këtyre nxënësve të mrekullueshëm që janë të gatshëm për të marrë dije islame dhe për të treguar përgaditjen e tyre për këto dije.

SELIM GOKAJ
KULLAJ ME 15 SHTATOR 2007

MINBERI ESHTË TRIBUNE E MENDIMIT ISLAM



Oratoria dhe mbajtja e një ligjërate, qe ka synim të bëjë për vehte një auditor, nuk është një dhuratë që Allahu i madhërueshëm ia ka bërë gjithkujt. Duke arsyetuar në këtë linjë edhe mbajtja e një hytbeje para një xhemati të caktuar ka të bëjë me përgaditjen e atij që do të mbajë një hytbe që ka si synim të arrijë një qëllim të caktuar. Që të arrijë qëllimin ka rendësi sa e ndjen ai atë që do të përcjellë tek xhemati dhe sa ka punuar me temën që do të flasë, që ajo të ketë parametra sa më të lartë fetar dhe parametra sa më oratorikë, që xhemati të ndigjojë dhe të jetojë ato për te cilat flitet nga minberi. Por, e verteta është se këtë mund ta bëjë vetëm ai që është i udhëzuar nga Allahu i madhërueshëm, të cilin e bën të ditur ajeti kuranor në suren (Bakare169)

...Vijon nga fq 4

ndërsjelltë me bajraktarët e Tophanës në Shkodër, të Shalës, të Shoshit, të Hotit. Ai ka pasur lidhje miqësore me Adem Haxhinë e Boksit, komandantin e shquar popullor, me Elez çelen të fisit të njohur Laçej te Pukës, etjerë. Halil Isufi ka marrë pjesë në të gjitha betejat që janë zhvilluar në mbrojtje të trojeve të kombit, bashkë me Adem Haxhinë deri sa vdiq në 1921-shin.

Halil Isufin e donin dhe e respektonin shumë bashkëkohësit e tij deri në atë masë sa që kurrë nuk e thërrisnin në emer por me epitelin "Bajraktar".

Ai nuk ka pasur arsim laik por vetëm fetar. Ai ka kryer mejtep për të mësuar se si duhet të lidhet muslimani me e Zotin e tij dhe si duhet të adhurohet, si duhet të kryhen detyrimet ndaj Zotit të Gjithësisë. Duke qenë një besimtar i devotshëm, ai ka falë nga pasuria e tij sipas ligjit Islam të Sheriatit dhe ka ndihmuar familjet e varfëra si familjet në Kala të

ku thuhet se Ai ia dhuron urtësinë atij që e do, e kujt i është dhënë urtësia, atij pra i është dhuruar mirësiat madhe, përveç të mençurve këtë nuk e kupton kush.

Në Shqipëri kemi një numur të madh teologësh muslimanë që sot janë nxënës në dije, por nesër janë këto që do të jenë elita e dijetarve muslimanë në vendin tone, që do të bëjnë pa tjetër jehonë edhe jashtë hapësirave shqiptare. Sot, kapacitetet e tyre janë të njohura në medreze, ku ato japin mësim dhe nëpër xhamia, ku ato janë përballë xhematit të këtyra xhamiave, të cilave u përcjellin mesazhe islame. Pa tjetër që sukcesi i tyre dhe niveli i dijeve që ato përcjellin në këto hapsira islame, është i lidhur me shkallën e njohurive që ato kanë dhe me përpjekjet për të rritur shkallën e dijes që ato kanë përvetësuar në shkollat fetare që ato kanë kryer. Xhamiat janëfalore të Allahut të madhërueshëm dhe në këto falore xhemati, që ndigjon fjalën e hoxhës, është i interesuar që këtë fjalë ta bëjë të tijën dhe ta përçojë në ato ambiente ku ai jeton dhe punon, duke u bërë kështu

pjesë e përhapjes së dijes islame. Prandaj, ka rendësi të jashtzakonshme që ai, që mban ligjëratën fetare në minber, duhet të jetë i përgaditur në një shkallë sa më të lartë. Ka rendësi që minberi të shërbejë vetëm për të përcjellë mesazhe islame dhe asnjëherë nuk duhet të jetë tribune ku mund të spostohet qëllimi kryesor për të cilin ai shërben. Në momentin, kur muslimanët po penalizohen dhe po akuzohen pa asnjë të drejtë, mision të cilin e kanë marrë sot në dorë mediat e shkruara dhe ato vizive, është bërë detyrë parësore që në hytbe të bëhet politikë në favor të muslimanëve duke i bërë të njohur xhematit situatën në të cilën janë sot muslimanët, sepse një hytbe pa politikë

islame është një hytbe e vdekur dhe se për imamët, që flasin para xhematit nga minberi, është pjesa politike pjesa më e rëndësishme e ligjëratës që ai mban. Por, për fat të keq, shumë nga imamët tone, që në fakt janë pjesa dërmuese e tyre, janë larg mediave dhe vuajnë nga një përkushtim për të përcjellë edhe mesazhe politike në hytbet e tyre para xhematit të cilit ato duhet t, i përcjellin mesazhe islame. Muslimanët janë shumë të interesuar që nga minberi i haxhës të marrin mesazhe të sakta edhe për festat e tyre fetare duke qenë të interesuar që imami t, ua bëjë të qartë se ato duhet të përjashtojnë festat të ilat po u imponohen si festa popullore, por që nuk kanë asgjë të përbashkët me muslimanët, kujtojmë këtu festën e Vitit të Ri, Shën Valentinin, Shën Gjergjin 8 Marsin të cilat shumë muslimanë i kanë bërë festa të tyre, duke harruar se Profeti a. s. na ka lënë porosi që duhet të festojmë dy festa të cilat janë: Fitër Bajrami dhe Kurban Bajrami që janë të mjaftueshme për një musliman. Prandaj, imamët duhet të jenë të orjentuara edhe nga institucionet fetare, që për asnjë arsye të mos i anashkalojnë këto probleme me idenë sa ato janë të ditura, sepse gjynahi, që ato do të marrin, do të jetë i tillë aq sa, peshorja që do t, i peshojë, nuk do të gjendet lehtë. Sukcesi i një hytbeje ka të bëjë edhe me qetësinë dhe qartësinë e ligjëratës që mbahet nga mitberi, sepse Profeti ynë i nderuar ishte i qetë, nga hytba e pare deri tek hytba e Lamtumirës duke u lënë amenet imamve që ta ndjekin në hytbe rrugën e tij, që xhemati mos të spostohet nga përmbajtja e ligjëratës nga një tonalitet i lartë, ose nga një ligjëratë që i ngjan një murmuritjeje. Xhemati ka fatin e madh të jetë para një minberi nga ku imami i përcjell atij mesazhe nga fjala e Allahut. Kjo është edhe përgjegjësia me të cilën është i ngarkuar imami, kur mban ligjëratën e tij. Dhe, që të dale krenar para Allahut xh. sh. dhe para xhematit, që ka para syve të vet, ai duhet të jetë i përgaditur, i përkushtuar, i qetë, i ndërsjell në fjalën e tij, sepse vetën në këtë mënyrë xhemati do të jetë shumë i lumtur, që pati fatin të përcjellë një hytbe të bazuar në parametra të lartë fetarë, një hytbe ku ai qartësohet për pozitën politike të muslimanëve në të gjitha hapësirat ku ato jetojnë, Vetëm hytbe të tilla, do ta bëjnë mitberin një tribune të mendimit islam.

KASEM ZYLJA
SHKODER, ME 24. 9. 2007

Drishtit dhe në fshatra të tjera.

Halil Isufi ka treguar një kujdes të veçantë ndaj xhamisë si ndërtesë kulturi. Në xhami, që edhe sot ndodhet në qendër të lagjes Kala, ai ka vendosur shtylla anës rrugës me fenerë ndriçues, në drejtim të portës së lindjes sipër dhe asaj të përendimit poshtë. Gjatë gjithë natës xhamia dhe rruga kryesore e lagjes nga porta në portë ishte nën ndriçimin e fenerëve, që bashkë me gjelbërimin e manave anës rrugës dhe dritën e hënës krijonin një pamje të magjishme. Lagja Kala merrte pamjen e një qytetërimi në antikitet. Në mendjen dhe shpirtin e Halil Isufit reflektohej arti i qytetërimit të Drivastit të lashtësisë.

Halil Isufi i erdhi një vdekje e shpejtë dhe jo e zakonshme, megjithatë fisi i bajraktarit ruajti gjithmonë burrërinë dhe fisnikërinë, siç e kanë pasur rregullat dhe kanuni i maleve. Mbas vdekjes së Halil Isufit detyrën e bajraktarit e mori Myrto Dani, nipi i Halil Isufit, ndërsa sot këtë ofiq e gëzon Ymer Myrto

Muhaj, Djali i Myrto Danit.

Fisi i Bajraktarit të Drishtit është fisi më i nderuar në Drisht. Ai ruan traditat më të mira të fisnikërisë, të bujarisë, trimërisë, të besës, të respektit dhe të dashurisë njerëzore. Në moralin e shoqërisë njerëzore më trimëri është me falë se me vra. Njeriu ka një jetë që Zoti ia ka dhuruar dhe vetëm Ai ka të drejtë t'ia marrë atë. Njeriu është i privuar nga Zoti i Gjithësisë në këtë të drejtë. Njeriu duhet të jetë falës sepse duke falur fisnikërohet shpirti i tij, pra fiton veti hyjnore.

Halil Isufi do të mbetet kujtimi më i bukur dhe njeriu më i nderuar i Postribës në brezat që do të vijnë pas. Ai do të rrezatojë gjithmonë tek ne fisnikëri, paqe, respekt e dashuri njerëzore. Ai do të mbetet gjithmonë mishërim i trimërisë, burrërisë, besës, fisnikërisë dhe paqes mes fiseve e bajraqeve të Postribës.

Nga Riza Spahija

Deklaratë për Shtyp

19-shtator-07

FMSH shqetësohet nga fushata kristjanizuese dhe abuzimi me Nënë Terezën



Forum i Muslimanëve të Shqipërisë, ndjehet i shqetësuar për mospërfilljen e organeve shtetërore për t'i dhënë përgjigje kërkesës së Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të Bashkësisë Islame të Shqipërisë (përfaqësuese e një pjese të rëndësishme të popullit tonë), e cila ka kërkuar që në kartën e identitetit të shtetasve shqiptarë, të mos vihet figura e Nënë Terezës, pasi në këtë mënyrë shkelet karakteri laik i shtetit shqiptar, i sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Sipas kësaj kushtetute, shteti ynë duhet të respektojë besimet fetare të gjithsecilit, të marrë në mbrojtje lirinë e besimit dhe bashkësitë fetare, dhe nuk duhet të mbajë anën e asnjërës prej tyre. Por në vend që të bëjë këtë, qeveria jonë ka shpallur në ditët e fundit 'dhjetë ditët e Nënë Terezës', duke kaluar çdo masë në ekzagjerimin e gjërave.

Forum i Muslimanëve të Shqipërisë, shpreh keqardhje që figura e respektuar e Nënë Terezës po keqpërdporet për qëllime politike në këtë mënyrë.

Tashmë është e qartë për këdo, se për të realizuar objektivin e tyre dhe futur Shqipërinë në Bashkimin Evropian, politikanët tanë rendin të përfitojnë nga çdo rast, për të vënë në dukje 'rrënjët kristjane' të popullit tonë, pavarësisht se shumica e shqiptarëve kanë shekuj që janë

shkëputur prej tyre.

Forum i ynë vë re me keqardhje që politika jonë sot po vazhdon të ndjekë vijën e përcaktuar më parë nga ish-presidenti Alfred Moisiu, të shpallur në fjalimin e tij në Unionin e Oksfordit në nëntor 2005, kur deklaroi se shqiptarët nuk janë muslimanë, dhe po ti gërvishtës pak dalin të krishterë'. Zoti Moisiu në mënyrë spekulative dhe cinike, si shqiptarë klasifikonte vetëm ata që jetojnë brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë, ndërsa shqiptarët që rrojnë në trojet etnike në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi, ku shumica dërrmuese e tyre janë të fesë islame, ua hoqi kombësinë me një të rënë të lapsit.

Për të afishuar përpara Evropës 'rrënjët kristjane të shqiptarëve', kohëve të fundit në vendin tonë po ngrihen kudo buste të Nënë Terezës dhe emrin e saj po e marrin institucione, sheshe dhe objekte të rëndësishme. Kulmi i kësaj fushate kult-ndërtuese u arrit në fundin kur në aeroportin ndërkombëtar 'Nënë Tereza', u përrua shtatorja e saj në formë kryqi, pamja e së cilës do të jetë kontakti i parë i çdo të huaji që viziton Shqipërinë.

Në shërbim të këtij afishimi edhe Gjergj Kastrioti Skënderbeu (të cilin rilindasit tanë me mençuri ia dolën që ta bëjnë të pranueshëm si hero kombëtar për të gjithë shqiptarët si simbol bashkimi, lirie dhe rezistence), kohët e fundit ka

filluar të paraqitet si 'atlet i Krishtit', 'shpëtimtar i Evropës së Krishterë nga rreziku osman' etj. Politikanët tanë janë aq të obsesionuar nga strategjia e tyre për t'i paraqitur shqiptarët përpara Evropës ashtu siç nuk janë, sa që nuk duan t'ia dinë edhe nëse presidenti Xhorxh W. Bush i karakterizon ata si 'muslimanë që jetojnë në paqe', apo kur znj. Doris Pack deklaroi që përkatësia islame e shumicës së shqiptarëve nuk është aspak pengesë për pranimin e vendit tonë në BE, madje nuk përbën pengesë as fakti që Shqipëria bën pjesë në Organizatën e Konferencës Islamike.

Me vendosjen në kartat e identitetit të shtetasve shqiptarë të figurës së Nënë Terezës, të cilën Kisha Katolike po përgatitet ta shenjtërojë, politika jonë synon të ngjyrosi të gjithë shoqërinë shqiptare me një imazh të krishterë.

Përballë kësaj fushate kristjanizuese, ne e kemi të vështirë të kuptojmë, nëse me të vërtetë politikanët tanë duan që të tregohen më katolikë sesa Papa?

**FORUMI MUSLIMAN I SHQIPËRISË
TIRANË**

Njoftim për editorët:

Forum i Muslimanëve të Shqipërisë është një organizatë e shoqërisë civile, qëllimi i të cilës është të luftojë racizmin, islamofobinë dhe ksenofobinë.

*Për më shumë informacion vizitoni sajtin tonë:
www.forumimusliman.org*

PERSE U HIDHERUA MUHAMEDI A.S.

Njërit nga të pranishmit, në një falje në xhami, e ndëgjoi Muhamedin a.s. të thoshte: "Unë nuk do ta fal namazin e sabahut më me xhemat, sepse imami e zgjat namazin duke lexuar Kurandin. Transmetuesi i këtij hadithi, Ibn Mes, hudi, thotë se asnjëherë nuk e kishte pare të Dërguarin e Allahut të hidhërohet aq shumë sa në këtë ras, pas të cilit ai filloi të na këshillojë se në mesin tuaj ka prej atyre që bëjnë përçarje dhe e prishin xhematin.. Imami, që drejton faljen, duhet të lexojë pjesë të shkurtëra të Kuranit

,sepse në mesin e xhematit ka edhe njerëz që janë të sëmurë, pleq si edhe njerëz që kanë nevojë të tjera

QENDRA ME E MADHE I FESE ISLAME NE BOTE

Qendra më e madhe e islamit në botë konsiderohet Qendra Islame "Ahmed EL Feht" i cila është në shtetin e Bahrejn

Kjo qendër ka një sipërfaqe 190 mijë kilometra katrorë. Në këtë kompleks është një xhami madhështore, një bibliotekë speciale shumë e pasur, sallone për ligjërata fetare, salla konferencash dy minare madhështore me një kube 39 metra e lartë.

Kjo qendër është bërë një ambjent ku vizitorët vendas dhe të huaj arrijnë në një numur me të vërtetë mahnitës

PESHKU QE U BE MREKULLI

Nje peshkatar indian shikoi i shqetësuar se tregëtia me peshkun, që ai e kishte zënë, nuk po i ecte mbarë .Por, papritmas gjithshça ndryshoi në tregëtinë e tij të peshkut .Ai vure re se një nga peshqit ,që ai kishte zënë ,kishte të shkruara në lekuren e tij disa shkronja arabe. Pasi e çoi peshkun tek hoxha më i afërt ai e mori vesh se në lekuren e peshkut ,që kishte zënë ,ishite e shkruar me shkronja arabe një pjesë e shahadetit e cila ishte:"Nuk ka zot tjetër përveç Allahut"

Pak momente më vonë, në dyqanin e tij u grumulluan shumë njerëz për të pare këtë mrekulli duke shpresuar se edhe ato mund të blinin një peshk si ai që kishte mbi lekuren e tij mrekullinë të cilën e takoi peshkatarin fatlum...

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ
BISMIL-LAHIRR-RRAHMANIRR-RRAHIME

Tregtojme
MISH HALLALL

E XHUMA PUSHIM → BESNIK ALUSHI ISMETI

Produkte Hallall

**KLIENTË TË NDERUAR!
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

- 1- Produkte mishi hallall si: sallam, suxhuk etj.**
- 2- Piceri hallall**
- 3- Fast Food hallall**

Ju keni të drejtë të blini ku të doni por hallalli i vërtetë është vetëm tek market "ISMETI"

Adresa: Pranë teatrit "MICJENI"
Cel: 0692101893

EJANI TEK NE! FABRIKA E PERPUNIMIT
TE DRURIT

ILIRIA

me pronar Haxhj Ilir Muja (aktivist dhe bamirës Islam), ju afrojmë prodhime nga me të thjeshtat deri në dhoma gjumi. Shërbehet në kohë dhe me cilësi të lartë:

- Prodhim dyer e dritare
- Dhoma gjumi
- Pajisje zyresh
- Pajisje kuzhine
- Dhoma fëmijësh

Pajisje për ambiente lokale
Te gjitha këto me çmime konkurruese dhe me transport të garantuar falas. Ejani në fabrikën tonë dhe do të mbeteni të kënaqur. Mund të kontaktoni me numrin e mobilit: 0692523565

